



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**  
**DREJTORIA E SHQYRTIMIT DHE MONITORIMIT TE LEJEVE MJEDISORE DHE VNM**

AN230820240008

Tiranë, më 02.10.2024

Komisioni 126

## DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

### VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Personi juridik:** “NELI” Sh.p.k.

**Nr. NIPT-i:** J68103906N

**Adresa e selisë:** Galeria nr.7, 3/2, Martanesh

**Personi përgjegjës:** Urim Koci

Për të zhvilluar projektin “**Shfrytëzim i mineralit të kromit, ish leja minerare kërkim zbulimi Nr 1929, datë 08.02.2022**”

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

**Vendndodhja:** Objekti “Balgjaj”, Bashkia Klos, Qarku Dibër.

### **Të dhëna teknike:**

*mbështetur në deklaratimet e AKBN*

Sipërfaqe totale e lejes minerare të shfrytëzimit është 1.178 km<sup>2</sup>

Sipërfaqja që preket nga shfrytëzimi e miratuar në Këshill Teknik është 1.821 Ha

Lloji i mineralit: Krom

*(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

**Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

**1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:**

*Drejtoritë teknike të ministries shprehin mendimin si më poshtë vijon:* Sugjerohet që gjatë ndërtimit të veprimtarisë, mbetjet e gjeneruara të menaxhohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e mbetjeve si më poshtë:

- Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;
- Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, date 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”;
- Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.
- Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar;
- Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar;
- Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me liçensë III.2.B si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve“ i ndryshuar;
- Gjatë fazës ndërtimore mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24. 06. 2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- Për të gjiitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.

Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

o Me qëllim mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe në zbatim të legjislacionit përkatës për këtë fushë, sugjerohet që gjatë fazës së ndërtimit të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;
- Të spërkaten rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;
- Automjetet transportuese, të mos ngarkohen më shumë së kapaciteti i tyre mbajtës, si dhe të mbulohen me struktura të posaçme, për të shmangur përhapjen e pluhurave dhe derdhjen e materialeve që transportohen, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.
- Me qëllim mbrojtjen e mjedisit, përdorimi i lëndëve plasëse, të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 74/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”.  
o Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, sugjerohet që të kryhet rehabilitimi i plotë i sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit.  
Lidhur me bazën ligjore të cituar në raportin e VNM-së, vlerësojmë se në raport nuk është cituar ligji në fuqi nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike.
- o Drejtoria e natyrës dhe pyjeve shprehet kundër miratimit, për arsye se:
  - Në dokumentacion nuk relatohet nëse është patur parasysh pika 6, neni 10, i ligjit 57/2020 “Për pyjet” dhe në mënyrë të veçantë neni 12, i tij;
  - Në konsultimin me publikun, nuk gjejmë mendim nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki apo Njësia e Qeverisjes Vendore;
  - Nuk parashikohen masa për mbrojtjen nga zjarret në raste aksidentesh;
  - Fotot e objektit, ku propozohet të zhvillohet projektit janë të paqarta;
  - Përsa parashtrihen të dhënat/informacionet për përdorimin e sipërfaqes që do të përdoret përherë apo përkohësisht nga projekti (kjo bazuar në VKM nr.686, datë 29.7.2015, të ndryshuar, dhe VKM nr. 912, datë 11.11.2015, “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit në mjedis), nuk janë të saktësuara siç parashikohet dhe kërkohet nga legjislacioni në fuqi;
  - Lidhur me rehabilitimin ka vetëm përgjithësime dhe asgjë konkrete, sipas fazave dhe hapave të zbatimit të projektit të propozuar, kjo edhe bazuar në sipërfaqen shumë të madhe të kërkuar.  
Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr.10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve etj., të cilat duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

*Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet:* Bazuar në dokumentacionin dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti: “Shfrytëzim i mineralit të kromit leje minerare kërkim-zbulimi Nr. 1929 dt. 08.02.2022, Objekti “Balgjaj”, Bashkia Klos, Qarku Dibër, me zhvillues “NELI” dhe aplikues “INNOVATION DEVELOPMENT ENGINEERING”, me nr. Aplikimi AN230820240008, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

*Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë shprehet se:* Në vijim të aplikimit me Nr. AN230820240008, të depozituar në sistemin elektronik të lejeve për të cilin keni kërkuar mendim për VNM-në e thelluar për Deklaratë Mjedisore, për objektin: “Leje Minerare Kërkim-Zbulimi Nr.1929 Dt. 08.02.2022 objekti “Balgjaj”, Bashkia Klos, Qarku Dibër”, me Subjekt Zhvillues “Neli” sh.p.k., ju bëjmë me dije se:

Shoqëria “Neli” sh.p.k., ka aplikuar në QKB për shndërrimin e Lejes së kërkim-zbulimit Nr.1929, minerali krom, objekti “Balgjaj”, Bashkia Klos, Qarku Dibër, në Leje Shfrytëzimi..

Për sa më sipër, në zbatim të Ligjit Nr. 10 304 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shprehemi dakord për vazhdimin e procedurave për pajisjen e shoqërisë së mësipërme me lejen përkatëse në funksion të veprimtarisë minerare në zonën e licencuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

*Bashkia Klos shprehet se:* Referuar kërkesës së zhvilluesit Subjektit “NELI” sh.p.k. Nipt. J68103906N, me nr. AN230820240008 aplikimi, datë 23/08/2024 në lidhje me procedurën e VNM-së Thelluar për Deklaratë Mjedisore projektin “Shfrytëzim I Mineralit Te Kromit”, me vendndodhje mali “Balgjaj”, Njësinë Administrative Suç, Bashkia Klos.

Bazuar në ligjin 10440 datë 07.07.2011 për “Vlerësimin e Ndikimit në mjedis” i ndryshuar, bazuar në pikën 4b dhe 5 të Kreut II, të VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore”, të ndryshuar,

Bazuar në ligjin Nr. 57/2020 “PËR PYJET” Në nenet 5, 13, 16, 17, 25, 34, 35, 36, 37, Ligji Nr. 10304 në nenin 4. Si dhe raportin e KLSH-s Nr. 492/2 Prot date 27.05.2024: Bashkia Klos shprehet si më poshtë vijon:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit mbi zhvillimin e projektit bazuar në planvendosjen dhe kordinatat e aplikimit, për sipërfaqen ku kërkohet zgjerimin e aktivitetit të leje minerare kërkimzbulimi nr.1929 dt.08.02.2022 objekti “Balgjaj”, Bashkia Klos, Qarku Diber, Njësinë Administrative Suç, Bashkia Klos, me zhvillues “NELI” sh.p.k. dhe aplikues “Innovation Development Engineering”, me nr. Aplikimi AN170620240002 vërejmë se:

Subjekti me veprimtarinë minerare në Bashkinë Klos, nuk ka zbatuar parimet e veprimtarisë minerare që rregullon marrëdhëniet midis subjektit dhe titullarit të pronës, në përputhje me pikën 4 të nenit 4, ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” me ndryshimet e ligjit nr. 9/2013 dhe Ligjit nr.43 134/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për subjektin nuk është miratuar ndryshim nga fondi pyjor, parakushti për zhvillimin e aktiviteti minerar në zbatim të pikave 3, 5 e 8 të nenit 5 të ligjit 57/2020 “Për Pyjet” (nenin 17 “Heqja e sipërfaqeve (tokave) nga fondi pyjor kombëtar” të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar.

Pas komunikimit me subjektin mbi situatën e këtij procesi:

Subjekti u paraqit pranë bashkisë Klos me kërkesë Nr. 1746 prot. date 01.07.2024 Kërkesë për fillimin e procedurave për hartimin e kontratës mbi dhënien në përdorim / heqjen nga Fondi Pyjorë të sipërfaqes në proces marrje të lejes minerare për shfrytëzim. Nga ku sektori përkatës paralelisht me shqyrtimin e aplikimit për VNM-n e thelluar vazhdojmë procedurat për lidhjen e kontratës bazuar në veprimtarinë e kërkuar sipas projektit të paraqitur dhe sipas bazës ligjore të paraqitur më lart.

● Shprehim dakortësinë për vazhdimin e procedurave për VNM-n e thelluar paralelisht me procedurat e lidhjes së kontratës me Bashkinë Klos.

*Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibërt* sugjeron që subjekti të marrë masat që zhvillimi i projektit të kryhet në harmoni me mjedisin dhe me ndikim sa më minimal në të. Sugjerojmë zbatimin e masave të listuara më poshtë:

- Kamionat transportues të mineralit të kromit të jene të pajisur me bordura mbrojtëse dhe me mushama për të shmangur rënien aksidentale të mineralit dhe perhapjen e pluhurave. Të pastrohen gomat e makinave kur të dalin nga territori.

- Të zbatohen standardet dhe praktikat më të mira gjate përdorimit të lendeve plasese. Punëtorët të pajisen me kufje për mbrojtjen nga zhurma.
- Të përdoren sprucator për të shmangur përhapjen e grimcave të pluhurave si pasoje e shpërthimeve gjate shfrytëzimit të mineralit.
- Të bëhet trajtimi i ujërave të ndotur me grope dekantimi.
- Subjekti të ketë kujdes bimesinë në zonën ku do të ndërhyjë, duke pasur parasysh se në çdo rast të prerjeve apo shkuljeve të pemeve, gjate fazes së rehabilitimit ato të zëvendësohen me po të njëjtat lloj.
- Të parashikohen masat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh.
- Të zbatohet orari sipas legjislacionit në fuqi për levizjen e automjeteve, për të shmangur vibrimet dhe zhurmat në zonat e banuara.
- Në të gjitha rastet që do të ketë ndërhyrje në mjedis do të duhet të ruhet vegetacioni si edhe bimësia karakteristike zonale duke mos dëmtuar në asnjë rast peizazhin natyror të zonës së marrë në studim.
- Në rastet se gjate venies në zbatim të projektit dhe funksionimit të tij do të vërehet prania e flores dhe e faunës të cilat janë specie të rrezikuara ose endemike të tregohet kujdes i veçantë për të mos e dëmtuar ato.
- I gjithë territori i shfrytëzimit të rrethohet me rrjete për të parandaluar hyrjen e kafsheve të zonës.

## **2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

*Konsultimi me publikun:* U krye në datë 20.08.2024. pranë objektit të kromit, në fshatin Kurdari. Në këtë dëgjese morën pjesë banorët e fshatit Kurdari, Balgjaj, etj, të cilat janë fshatrat me të afërt me objektin e kromit., përfaqësues të pushtetit vendor, administratori Njësisë Administrative z. Erind Saliaj, përfaqësues të studios “Innovation Development Engineering” shpk, përfaqësues të subjektit “Neli” shpk dhe përfaqësues të ARM Tirane, Durres, Diber, etj.

Meqënëse kjo ishte dëgjesa e dytë brenda pak muajve, pjesëmarrësit e kishin të qartë aktivitetin duke e parë si të panevojshme bërjen e pyetjeve, prandaj ato kaluan në diskutime dhe bashkëbisedime të dobishme për sa i takon zhvillimit të aktivitetit minerar në objektin e kromit Balgjaj. Pas prezantimit të projektit të pranishmit nuk shprehen ankesë apo mosdakortësi për ushtrimin e këtij aktiviteti

## **3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;**

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Shkresën Nr 6803 Prot, datë 05.08.2024 drejtuar AKBN -së.
- Vendim i Këshillit Teknik të SHGJSH Nr 210/1, datë 14.02.2024, dërguar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, subjektit “NELI” Sh.p.k, Objekti “Balgjaj”, Bashkia Klos, Qarku Dibër
- Mendimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë,
- Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- Mendimine Bashkisë Klos,
- Mendimin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit.
- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 126, datë 01.10.2024, i mbledhur në zbatim të Urdhërin nr.82, datë 02.05.2024, nr.4934 prot, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”;

## **4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:**

- 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.**
- 4.2 Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.
- 4.3 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 4.4 Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.** Të ketë në vëmendje të veçantë referencat kadastrale që preken nga ushtrimi i aktivitetit.
- 4.5 Subjekti duhet të respektojë nenin 12, të ligjit 57/2020, pyjet janë pasuri kombëtare dhe funksioni i tyre prevalon mbi çdo interes.
- 4.6 Subjekti duhet të bëjë shfrytëzimin progresiv, bazuar në deklaratimet e AKBN-së.
- 4.7 Në bazë të Ligjit Nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”, nga zbatuesit e projektit të merren masa që mos të dëmtohen zona me status të veçantë.

**Gjatë fazës së instalimit:**

- 4.8 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.9 Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)
- 4.10 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.11 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.12 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.13 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.14 Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimit të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.15 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.16 Subjekti të hartojë dhe zbatojë një plan masash lidhur me masat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh nga plasjet për nxjerrjen e materialit.**
- 4.17 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.18 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësi vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

- 4.19** Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.20** Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.21** Të merren masa për mbrojtjen e biodiversitetit të zonës.
- 4.22** Të kihet kujdes treguesit kadastralë të sipërfaqes pyjore/kullosore që do të përdoret për aktivitetin, të jenë vetëm brënda sipërfaqes së miratuar.
- 4.23** Personi përgjegjës teknik për zhvillimin e aktivitetit duhet të jetë i informuar për bazën ligjore të pyjeve në fuqi dhe për zbatimin e tyre.
- 4.24** Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.25** Subjekti të respektojë dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 4.26** Subjekti të marre masa për rehabilitim e sipërfaqes së shfrytëzuar më parë.
- 4.27** Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.28** Në përfundim të punimeve, të rehabilitohet zona e shfrytëzuar.
- 4.29** Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligj nr. 52/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

## 5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

### - Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodi citeti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	04.04.2025	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	04.04.2025	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	04.04.2025	Çdo 6 muaj

*Tabela e niveleve kufi:*

- **Shkarkimet në Ajër**

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afërt me kantierin çdo 6 muaj.

*Tabela e niveleve kufi*

<b>Ndotësi</b>	<b>Përqëndrimi</b>	<b>Raportimi në AKM</b>	<b>Periodiciteti</b>
Lënda grimcore (PM <sub>2.5</sub> )	20-25 µg/m <sup>3</sup>	04.04.2025	Çdo 6 muaj
PM <sub>10</sub>	50 µg/m <sup>3</sup> , 40 µg/m <sup>3</sup>	04.04.2025	Çdo 6 muaj

- **Cilësia e ujrave**

*Parametrat që duhet të monitorohen*

<b>Ndotësi</b>	<b>Përqëndrimi</b>	<b>Raportimi në AKM</b>	<b>Periodicite ti</b>
Lëndët në pezulli	50 mg/l	04.04.2025	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Informacion për menaxhimin e mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara, të pajisura me Kod Unik.
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/ çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

- **Afati i Vlefshmërisë**

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

*Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.*



**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**ARTA DOLLANI**

**MINISTRI**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

*Konceptoi:*

*Pranoi:*

**Aneksi 1. Harta me Koordinatat** (bazuar në deklarimet e AKBN-së)

